

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

Kontabiliteti Menaxherial

P2

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI

Data 25.06.2016

PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga <u>ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</u>
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	25	
3. Problemi 3	15	
4. Problemi 4	20	
5. Problem 5	20	
Total	100	

Problemi 1

Vela Co. prodhon dhe shet një produkt të vetëm që quhet Produkti Y. Kompania aplikon sistemin e absorbimit të kostove për vlerësimin të produkteve të përfunduara (njësive dalëse) dhe stoqeve në fund. Shpenzimet e përgjithshme të prodhimit (shpp) fikse absorbohen për njësi të prodhimit duke përdorur shkallën e paracaktuar të aplikimit bazuar në nivelin e pritur të aktivitetit prej 258,000 njësi për vite. Shpenzimet fikse të përgjithshme të prodhimit të buxhetuar për vite ishin €5,160,000.

Nuk kishte stoqe fillestare në fillim të vitit financiar. Shitjet dhe prodhimet për tre muajt e parë të vitit ishin si më poshtë:

	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3
Shitjet në njësi	21,000	18,000	23,000
Prodhimi në njësi	21,000	22,500	20,000

Çmimi aktual i shitjes për njësi ishte €180. Kostot variabile të prodhimit për njësi ishin €80. Shpenzimet fikse të përgjithshme të prodhimit aktuale ishin si më poshtë:

Muaji 1: €410,000;

Muaji 2: €432,000

Muaji 3: €418,000.

Kostot fikse dhe administrative ishin €405,000 për secilin muaj.

KËRKOHET :

(a) Përgatitini pasqyrën e fitimit operativ për muajin 1, muajin 2, muajin 3::

- (i) Sipas trajtimit të absorbimit (përvetësimit) të kostos.
- (ii) Sipas trajtimit marxhinal të kostos,. (15 pikë)

(b) Shpjegoni dallimin në fitimin operativ për tre muajt sipas trajtimit të absorbimit (a)(i) dhe sipas trajtimit marxhinal të kostove (a)(ii). (5 pikë)

Zgjidhja 1

(a)

(i) Fitimi operativ - Trajtimi Absorbimit

	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3
Shitjet	3,780,000	3,240,000	4,140,000
Kostot e shitjeve			
St. fillim (@ €100 për njësi)	0	0	450,000
Prodhimi (@ €100 për njësi)	2,100,000	2,250,000	2,000,000
Zbritur – St. fund (@ €100 për njësi)	0	-450,000	-150,000
	<u>2,100,000</u>	<u>1,800,000</u>	<u>2,300,000</u>
(Mbi)/nën absorbimi	-10,000	-18,000	18,000
	<u>2,090,000</u>	<u>1,782,000</u>	<u>2,318,000</u>
Fitimi Bruto	1,690,000	1,458,000	1,822,000
Kostot fikse dhe administrative	-405,000	-405,000	-405,000
Fitimi Operativ	<u>1,285,000</u>	<u>1,053,000</u>	<u>1,417,000</u>

8 pikë

Fitimi operativ - Trajtimi Absorbimit

	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3
Shitjet	3,780,000	3,240,000	4,140,000
Kostot e shitjes variabilees			
St. në fillim (@ €80 për njësi)			
Prodhimi (@ €80 per unit)	1,680,000	1,800,000	1,600,000
Zbritur Stoku në fund (@ €80 për njësi)	0	-360,000	-120,000
	<u>1,680,000</u>	<u>1,440,000</u>	<u>1,840,000</u>
Kontributi	2,100,000	1,800,000	2,300,000
Kostot fikse të prodhimit	-410,000	-432,000	-418,000
Kostot fikse dhe administrative	-405,000	-405,000	-405,000
Fitimi Operativ	<u>1,285,000</u>	<u>963,000</u>	<u>1,477,000</u>

6 marks

Puna

Stoku në fillim dhe fund

	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3
St. fillim	0	0	4,500
Njësit e prodhimit	21,000	22,500	20,000
Njësit e shitura	-21,000	-18,000	-23,000
Stoku në fund	<u>0</u>	<u>4,500</u>	<u>1,500</u>

Kalkulimi i shitjeve

	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3
Njësit e shitjes	21,000	18,000	23,000
Çmimi I shitjes për njësi	180	180	180
Shitjet	<u>3,780,000</u>	<u>3,240,000</u>	<u>4,140,000</u>

7 pikë

Kalkulimi I shkalles së paracaktuar të absorbimit =

€5,160,000/258,000 njësi = €20 për njësi

Kalkulimi mbi/nën aplikimit

	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3
Shpp aktuale	410,000	432,000	418,000
Shpp të aplikuara (njësit e prodhimit * €20 për njësi)	-420,000	-450,000	-400,000
(Mbi)/Nën Aplikimi	-10,000	-18,000	18,000

(b) Rikonsolidimi i fitimeve :

	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3
Fitimi operativ – trajtimi absorbimit	1,285,000	1,053,000	1,417,000
Fitimi operativ – trajtimi variabil	1,285,000	963,000	1,477,000
	<hr/> 0	<hr/> 90,00	<hr/> -60,000

5 pikë

Problem 2

1. Kërkesa vjetore e kompanisë për Produktin Alfa është 50,000 njësi. Për secilën porosi të kompanisë për Produktet Alfa krijohet shpenzimi prej €120. Kostoja e mbajtjes për njësi e Produktit Alfa është €1 në muaj. Bazuar në këto informacione kalkuloni Sasinë e Porosis Ekonomike. (5 pikë).

2. Informatat e mëposhtme kanë të bëjnë me seksionin nën a dhe b

Për katër tremujoret e kaluar kemi paraqitur nivelin e njësisve dalëse në raport me shpenzimet e përgjithshme të prodhimit (Shpp):

	Njësit dalëse	Shpp
Tremujori 1	8,000 njësi	€37,000
Tremujori 2	7,000 njësi	€34,000
Tremujori 3	9,000 njësi	€39,000
Tremujori 4	5,000 njësi	€27,000

- a) Bazuar në informatat e dhëna më lartë, duke përdorur metodën lart-poshtë vlerësoni pjesën e kostove fikse nga shpenzimet e përgjithshme të prodhimit (2.5 pikë) :

b).Bazuar në informatat e dhëna më lartë vlerësoni kostot totale të shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit në nivelin e njësisve dalëse të 6,000 njësisve (2.5 pikë) :

3. Kola Co prodhon tre lloje të produkteve: Produktin X, Produktin Y dhe Produktin Z. Informatat e mëposhtme janë dhënë për produktet:

	Produkt X	Produkt Y	Produkt Z
Maksimumi i kërkesave të shitjes	4,000	3,000	6,000
Orët e punës për njësi	3	4	2
Orët e makinerisë për njësi	1	2	1
Kontributi për njësi	€9	€8	€5

18,000 orë makinerie dhe 30,000 orë pune janë në dispozicion për përdhën që po vjen.

Bazuar në këto informata paraqiteni planin optimal të prodhimit për secilin produkt për Kola Co (

5 pikë) .

4).Keko Co aplikon sistemin e kostove të proceseve. Gjatë muajit Qershor janë futur materiale direkte për prodhimin e 4,000 njësive me kosto €6 secila në Procesin 1. Kostot e konvertimit prej €12,800 kanë ndodhur gjatë muajit. Humbja normale për Procesin 1 pritet të jetë 10% e njësive hyrëse dhe njësit në humbjen normale mund të shiten si mbeturina me €2 për njësi. Një humbje aktuale prej 200 njësish është regjistruar. Nuk kishte stoqe fillestare dhe përfundimtare të punës në proces në muajin Qershor. Kalkuloni vlerën për një njësi të njësive dalëse (5 pikë).

5). Soke Co. kërkon 5,000 njësi të Produktit A për përdorim në një porosi speciale. Soke Co momentalisht ka 4,000 njësi të Produktit A në stoqe. Stoqet ishin blerë disa vite më herët me çmim €6 për njësi. Nëse stoqet e 4,000 njësive nuk përdorën për porosinë speciale ato duhet të largohen nga Stoke Co. me kosto €1 për njësi. Çmimi aktual i blerjes për Produktin A është €7 për njësi. Bazuar në të dhënat e mësipërme kalkuloni kalkuloni kostot relevante për 5,000 njësi të Produktit A që do të përdorën në porosinë speciale (5 pikë).

Zgjidhja 2

1.

$$Q = \sqrt{\frac{2DO}{H}}$$

$$\sqrt{\frac{2 * 50,000 * 120}{12}} = 1,000$$

2

a.	5,000 units	€27,000
	9,000 units	€39,000

Kostot fikse=:

$$€27,000 - (5,000 * €3) = €12,000$$

b.

$$(€3 * 6,000) + €12,000 = €30,000$$

3

$(4,000 * 1) + (3,000 * 2) + (6,000 * 1) = 16,000$ Orët e makinerisë janë të mjaftueshme pasi kemi 18,000 orë në dispozicion.

$(4,000 * 3) + (3,000 * 4) + (6,000 * 2) = 36,000$ orë pune kërkohen, ndërsa në dispozicion i kemi vetëm 30,000 orë.

Fitimi për orë	Produkt X	Produkt Y	Produkt Z
Renditja	€3 1	€2 3	€2.50 2

Kemi

4,000 njësi të produktit X – Orët e shpenzuara 12,000 orë pune

6,000 njësi të produktit Z – Orët e shpenzuara 12,000 orë pune

1,500 njësi të produktit Y – Orët e shpenzuara 6,000 orë pune

4.

Materiali 4,000 @ €6	24,000
Kosto e konvertimit	<u>12,800</u>
	36,800
Zbritur Vlera e mbeturinave të humbjes normale (10% * 4,000 njësi) * €2	<u>-800</u>
	36,000
Njësit e pritura (90% * 4,000 njësi)	3,600
Kosto për njësi	€10

5.

Kursimet nga largimi i mbeturinave në stoqe 4,000 njësi @ €1 për unit	-4,000
Kostot shtese 1,000 njësi të blera me vlerën e tregut	<u>7,000</u>
	3,000

Problemi 3

Teni Co është një prodhues i produkteve për pastrime shtëpiake. Kompania ka angazhuar një agjent shitje të quajtur Selit Co. e cila merret kryesisht me aktivitete të marketingut dhe të shitjes. Selit Co. pranon një komision të shitjes prej 9% nga Teni Co. për shërbimet në shitjes. Buxheti i mëposhtëm paraqet pasqyrën e të ardhurave për vitin e ardhshëm.

	Teni Co – Pasqyra e të Ardhurave e Buxhetuar	€	€
Shitjet			850,000
Kostot e shitjes			
Materiali Direkt	170,000		
Puna Direkte	51,000		
Shp. përgjithshme fikse	<u>127,500</u>		
Fitimi Bruto			501,500
Shp. shitjes dhe shpërndarjes			
Komisionet e shitjes - Seli Co	76,500		
Shp. Variable të shpërndarjes	34,000		
Shp. Fikse të shpërndarjes	<u>92,000</u>		202,500
Kostot fikse Administrative			130,000
Fitimi Buxhetuar			<u>169,000</u>

Menaxhmenti i Teni Co. aktualisht është duke konsideruar anulimin e marrëveshjes me Selit Co. dhe mendon të punësoi dy agjent të shitjes të cilët punën e bëjnë nga shtëpia. Menaxhmenti kalkulon kostot që lidhen me këtë opsion. Agjentet e shitjes do të kenë rrogën bazë prej €22,000 në vite secili, dhe do të ju paguhet edhe një provizion prej 2% e shitjeve. Teni Co. i duhet të shpenzoj edhe €10,000 në vite për reklama dhe marketing.

KËRKOHET:

- (a) Kalkuloni pikën e rentabilitetit në të hyra për vitin e ardhshëm të Teni Co. kur kompania vazhdon të përdor shërbimet nga Seli Co. (5 pikë)
- (b) Kalkuloni nivelin e shitjeve të Teni Co. që nevojiten për të realizuar një fitim prej €169,000 për periudhën e ardhshme nëse kompania punëson dy agjentet e shitjes dhe anulon marrëveshjen me Selit Co. (5 pikë)
- (c) Kalkuloni nivelin e shitjeve të nevojshme në Euro për Teni Co. për dy skenarët e mësipërm në mënyrë që të arrihet FITIMI I NJËJTË për secilin skenar.

(5 pikë)

Zgjidhje e problemit 3

(a) Kalkulimi I koeficientit të kontributit ndaj shitjeve

Kostot variabile:		
Materiali direkt	170,000	20% e shitj.
Puna Direkt	51,000	6% e shit.
Komisionet e shit.	76,500	9% e shit.
Kost. Variabile shpernd.	<u>34,000</u>	4% e shit.
Total Kostot Variabile	331,500	39% e shit.
Të hyrat	850,000	100% e shit.
Fitim Kontributi	518,500	61% e shit.
Fitim Kontributi/Shitjet = Koeficienti		61%

Kostot fikse

Të prodhimit	127,500
Shpërndarjes	92,000
Administrimit	<u>130,000</u>
	349,500

Pika e rentabilitetit në të hyra

$$\text{Kostot Fikse} / \text{Fitim Kontributi/Shitjet} = 349,500 / .61 = \text{€}572,951$$

4 marks

(b) Kalkulimi I koeficientit të kontributit ndaj shitjeve

Kostot variabile:	
Materialet direkte	20% të shitjes
Puna Direkte	6% të shitjes
Komisioni i shitjeve	2% të shitjes
Shpërndarja	4% të shitjes
Total Kostot Variabile	32% të shitjes

Kontributi 68% e shitjeve (i.e. 100% - 32% kostot variabile)

Kostot fikse

Prodhimit	127,500
Shpërndarjes	92,000
Administrimit	130,000
Agjenteve të shitjes (2 * €22,000)	44,000
Reklamës	10,000
	403,500

$$\text{Të hyrat} = 403,500 + 169,000 / .68 = \text{€}841,912$$

$$68\% \text{ Shit} - 403,500 = 61\% \text{ Shit} - 349,500$$

$$7\% \text{ Shit} = 403,500 - 349,500$$

$$7\% \text{ Shit} = 54,000$$

$$\text{Shit} = 771,429$$

5 marks

Problemi 4

Fiki Co prodhon një produkt të vetëm që quhet Kat. Kompania përdor sistemin variabil të përvetësimit të kostove për raportim të brendshëm . Kostot standarde të mëposhtme aplikohen për këtë produkt:

Karta Standarde e Kostos –Produkti Kat

Materiali Direk (5kg @ €10 për kg)	€50
Puna Direkte (6 orë @ €12 për orë)	<u>€72</u>
Kostot Standarde Variabile	€122
Fitim Kontributi Standard	<u>€38</u>
Çmimi i shitjes Standard	€160

Kompania nuk mban stoke të produkteve të gatshme, por i shet të gjitha prodhimet në muajin që prodhohen. Fiki Co. ka buxhetuar të prodhoj dhe shesë 30,000 njësi të Produktit Kat në korrik.

Shpenzimet e përgjithshme fikse të buxhetuara për vitin financiar ishin €7,290,000 dhe janë vlerësuar që ndodhin proporcionalisht përgjatë gjithë vitit.

28,000 njësi aktualisht janë prodhuar dhe shitur në korrik. Detalet e kostove të ndodhura dhe të hyrave të gjeneruara për këtë muaj janë dhënë si më poshtë:

	€
Shitjet	4,760,000
Materiallet Direkte (146,000kg @ €12 për kg)	(1,752,000)
Puna Direkte (164,000orë @ €13 për orë)	<u>(2,132,000)</u>
Fitim Kontributi	876,000
Fikse shp.p.	(597,000)
Fitimi operativ	279,000

KËRKOHET:

(a) Përgatiteni Pasqyrën e të Ardhurave për Fiki Co. për korrik sipas:

- (i) Buxhetit Fiks;
- (ii) Buxhetit Fleksibil; dhe
- (iii) Rezultateve aktuale për muajin

NUK kërkohet nga ju të prezantoni variancat në këto pasqyra (6 pike)

(b) Kalkuloni variancat e mëposhtme:

- (i) Variancën e çmimit të materialit;
- (ii) Variancën e përdorimit të materialit
- (iii) Variancën e çmimit të punës
- (iv) Variancën e efikasitetit të punës
- (v) Variancën e shpenzimeve të përgjithshme të prodhimit
- (vi) Variancën e vëllimit të shitjes
- (vii) Variancën e çmimit të shitjes .(14 pike)

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja e problemit 4

(a) **Felix Ltd 6 (pikë)**
Performance Report - July

	Buxheti Fiks 30,000 njësi	Buxh. Fleksibil 28,000 njësi	Rez. Aktual 28,000 njësi
Shitjet	4,800,000	4,480,000	4,760,000
Kostot variabile			
Materiali direkt	1,500,000	1,400,000	1,752,000
Puna Direkte	<u>2,160,000</u>	<u>2,016,000</u>	<u>2,132,000</u>
	3,660,000	3,416,000	1,400,000
Fitmi Kontributi	1,140,000	1,064,000	876,000
Shpp Fikse	607,500	607,500	597,000
Fitimi	532,500	456,500	279,000

(b) (i) Varianca e çmimit të materialit
 $(€10 - €12) * 146,000 = €292,000P$

Varianca e përdorimit të materialit

$([5kg * 28,000] - 146,000kg) * €10 = €60,000P$

Varianca e çmimit të punës

$(€12 - €13) * 164,000 = €164,000P$

Varianca e efikasitetit të punës

$([28,000 * 6] - 164,000) * €12 = €48,000F$

Varianca e shpenzimeve fikse

$(607,500 - 597,000) = €10,500F$

Varianca e vëllimit të shitjes

$(30,000 - 28,000) * €38 = €76,000P$

Varianca e çmimit të shitjes

$(€160 - €170) * 28,000 = €280,000F(14 pikë)$

Problemi 5

Co Co. prodhon produktin AA në dy procese dhe informatat në vijim janë nxjerrë nga sistemi i kontabilitetit të kompanisë për periudhën që përfundon 31 Mars 2016.

Procesi 1 - Gjatë periudhës ishin futur materialë B për prodhimin e 10,000 njësive me kosto për njësi prej €5.60 në procesin 1. Kostoja e punës për procesin 1 ishte €48,000 dhe shpenzimet e përgjithshme janë €26,050. Humbja normale e procesit 1 është 15% e njësive hyrës dhe kjo ka vlerë të shitjes prej €1.70 për njësi. Nuk kemi stoke në hapjen dhe mbylljen të punës në proces. Njësit dalëse ishin 8,200 njësi.

Të gjitha njësit dalëse nga procesi 1, janë transferuar në procesin 2 për të cilin konsiderohen si lëndë e parë. Në periudhën në vijim, informatat e mëposhtme janë në lidhje me procesin 2.

Procesi 2 - Puna në proces në fillim është 800 njësi dhe vlera e kostove ishte €5,000 për materiale dhe €7,800 për kostot e konvertimit. Njësit ishin të kompletuara 100% sa i përket materialeve dhe 60% të kompletuara për kostot e konvertimit. Puna në proces në fund më 31 Mars 2016 ishte 640 njësi dhe 100% e kompletuar për materialet dhe 60% kostot e konvertimit. Kostoja e periudhës ishte €30,000 për punën direkte, €8,000 për punën indirekte dhe shpenzimet e përgjithshme ishin €11.584. Njësit dalëse nga procesi 2 për periudhën ishin 8,360 njësi.

Kërkohet:

- a. Përgatiteni llogarinë e procesit 1. (8 pikë)
- b. Përgatiteni llogarinë e procesit 2, duke përdorur FIFO metodën për vlerësimin e njësive dalëse dhe vlerën e stokut në fund të punës. (12 pikë)

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja e problemit 5

a.

Procesi 1					
Përshkrimi	Njësit	€	Përshkrimi	Njësit	€
Stoku fill	0	0			
Materiali			Nj. Dalëse	8,200	123,000
Gjatë periudhës	10,000	56,000	Humbjet Normale	1,500	2,550
Puna		48,000	Humbjet Jonormale	300	4,500
Shpp		26,050			
	10,000	130,050	-	10,000	130,050

$$K/NJ = (130,050 - 2,550)/8,500 = 15$$

b.

Procesi 2					
Përshkrimi	Njësit	€	Përshkrimi	Njësit	€
Stoku fill	800	12,800			
Materiali (Proc.2)	8,200	123,000	Nj. Dalëse	8,360	173,480
Puna		38,000			
Shpp		11,584	St. fund	640	11,904
	9,000	185,384	-	9,000	185,384

Njësit ekuivalente

Përshkrimi	Materialë	Kostot e konvertimit
St. fill	-	320
Nj. Fill dhe të mbaruara	7,560	7,560
St. fund	640	384
Total	8,200	8,264

$$K/NJ \text{ Material} = 123,000/8,200 = 15$$

$$K/NJ \text{ Konvertimit} = (30,000+8,000+11,580)/8,264 = 6$$

$$\text{Njësitë dalëse} = (320 \times 6) + 5,000 + 7,800 + (7,560 \times 21) = 173,480$$

$$k/nj = (15 + 6) = 21$$

$$\text{St. fund} = (640 \times 15) + (384 \times 6) = 11,904$$